




Republika e Kosovës




Kuvendi i Komunës- Vushtrri



RREGULLORE
PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRRAT
VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË

Shtator 2009



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës – Vushtri

01Nr.616/09
Më:24.09.2009

Në bazë të nenit 11, nenit 12 pika 12.2 “c”, nenin 34.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Udhëzimin e MAPL-së 2008/8 për Marrëveshjet e bashkëpunimit të Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane si dhe nenin 10 dhe 11 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 24.09.2009, miraton këtë:

**RREGULLOREN
PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT,
VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE TË KOMUNËS SË VUSHTRISË**

Neni 1.

Qëllimi

1.1 Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Vushtrisë në ushtrimin e aktiviteteve që janë në kompetencë të komunës.

Neni 2.

Numri i fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve të komunës

2.1 Për të realizuar sa më mirë funksionet e parapara me të Ligjin për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë, Statutin e Komunës dhe këtë Rregullore Komunale, Komuna e Vushtrisë është e organizuar në gjithsejtë 67 fshatra si dhe dy lagje urbane, “Kalaja” dhe “Dardania”.

Neni 3.

Përgjegjësitë e bartura nga komuna në Këshillat e fshatrave

3.1. Me kërkesën e Këshillit të fshatit dhe rekomandimin e Kryetarit të komunës apo ndonjë Komitetit të Komunës, Kuvendi i Komunës me vendim mund të bartë disa përgjegjësi për t'i ushtruar Këshillat e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.

3.2. Komunat ofrojnë përkrahje profesionale dhe financiare për fshatrat, dhe lagjet urbane, me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë së bartur.

Neni 4

4.1. Kuvendi i Komunës, me vendim të veçantë do të caktoj mënyrën e kompensimit të Kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe të lagjeve urbane, për punën dhe aktivitetet e tyre zyrtare.

Neni 5.

Bashkëpunimi i fshatrave vendbanimeve dhe lagjeve urbane

5.1. Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Vushtrrisë me pëlqimin e tyre mund të organizohen dhe bashkëpunojnë në mes veti për ushtrimin e aktiviteteve të përbashkëta të bartura nga komuna, si dhe formojnë këshillat e përbashkëta. Vendimin për këtë e miraton Kuvendi i Komunës në bazë të kërkesës së fshatit apo lagjes.

Neni 6.

Organizimi i fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane

6.1. Secili fshat, vendbanim apo lagje urbane e komunës zgjedhë Këshillin dhe Kryetarin e fshatit, vendbanimit apo lagjes, përmes votimit të fshehtë apo të hapur në tubimin e qytetarëve.

6.2. Në përbërjen e Këshillit të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane duhet respektuar parimet e përfaqësimit gjinor, dhe të përfshihen së paku 30% e femrave.

6.3. Këshilli i fshatit, vendbanimit apo lagjes mund të ketë prej 5 deri në 9 anëtar. Numri i saktë i anëtarëve për secilin këshill përcaktohet me vendim të Kuvendit të Komunës në bazë të kësaj rregulloreje.

6.4. Këshilli dhe Kryetari i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane zgjidhet me mandat 4 vjeçar.

6.5. Këshilli, anëtarët dhe Kryetari i këshillit aktivitetin e tyre e zhvillojnë sipas vendimeve të nxjerrura nga Kuvendi i Komunës dhe në pajtueshmëri me këtë rregullore.

6.6. Këshilli, anëtarët dhe Kryetari i këshillit mund të shkarkohen edhe para kalimit të mandatit, nëse nga zgjedhësit e tyre konstatohet se nuk kanë kryer obligimet që dalin nga kjo rregullore dhe legjislacioni i zbatueshëm.

6.7. Shkarkimi i këshillit dhe Kryetarit të këshillit bëhet sipas procedurës së njëjtë zgjedhjes së Këshillit dhe Kryetarit.

Neni 7.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e këshillit

7.1. Këshilli i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara si më poshtë:

- Harton dhe miraton rregullat e punës së këshillit;

- Organizon, përcjellë dhe planifikon zhvillimet e lokalitetit në bashkëpunim me Kuvendin e Komunës, Kryetarin e Komunës, komitetet dhe drejtoritë komunale;
- Emëron komisionet përkatëse për t'i realizuar objektivat e fshatit, vendbanimit dhe lagjes;
- Harton planet dhe programet zhvillimore të lokalitetit në të gjitha sferat;
- Ndërmerr iniciativa për ruajtjen e objekteve në pronësi të komunës dhe në pronësi shtetërore dhe pasurive tjera të paluajtshme shtetërore në lokalitetin përkatës;
- Raporton për mjetet e inkasuara për projekte të caktuara dhe i bënë ato transparente për qytetarët e atij lokaliteti në harmoni me dispozitat e Statutit të Komunës dhe kësaj rregulloreje;
- Siguron të dhënat elementare për çdo familje të lokalitetit përkatës, përcjellë gjendjen ekonomike të tyre dhe jep rekomandime e propozime në lidhje me këto të dhëna,
- Këshilli nxjerr vendime dhe rekomandime në interes të qytetarëve të lokaliteteve në komunë, në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm;
- Në bazë të nevojave dhe të kërkesës së qytetarëve apo me iniciativën e Këshillit mund të përcaktohet grumbullimi i vetë kontributit të qytetarëve në pajtueshmëri me legjislacionin e zbatueshëm.

Neni 8.

8.1 Këshilli i fshatit apo lagjes urbane mban mbledhje për çështje të caktuara nga kompetenca e tij sipas nevojës, por duhet të mbaj s'paku 2 (dy) mbledhje brenda një viti kalendarik.

Neni 9.

Bashkëpunimi i organeve të komunës me këshillat e lokaliteteve

9.1. Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, komitetet dhe drejtoritë komunale të Komunës së Vushtrrisë, koordinojnë punët me këshillat e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane përmes kryetarëve të këshillave, varësisht nga specifikat që do të trajtohen.

Neni 10.

Mospërmbushja e përgjegjësive

10.1. Për të gjitha punët e bartura në Këshill nga Kuvendi i Komunës, Këshilli i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane përkatëse mban obligime dhe përgjegjësi ligjore në rast të keqpërdorimit eventual.

10.2. Përgjegjësia mund të jetë individuale apo kolektive para qytetarëve dhe organeve përkatëse.

Neni 11.

11.1 Zbatimin e kësaj Rregulloreje do ta bëj Kryetari i Komunës përmes drejtorit të Drejtorisë për Administratë.

Neni 12.

Epërsia e aktit

12.1. Në rast të konfliktit të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale apo Statutit të Komunës mbizotërojnë dispozitat e ligjit apo statuti.

Neni 13.

Hyrja në fuqi

13.1 Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ministria përgjegjëse për vetëqeverisje lokale.

Neni 14.

14.1 Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet rregullorja 01Nr.962, dt 15.03.2002.

Neni 15.

15.1 Kryetari i Komunës, përmes Drejtorit të Drejtorisë për Administratë, brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje do të i ndërmerr veprimet e nevojshme për zgjedhjen e Këshillave të Fshatrave dhe Lagjeve Urbane, në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.



Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi
Ferit Idrizi

